




PRISHTINË

Akademia e Shkencave
dhe e Arteve e Kosovës
Rr. "Agim Ramadani"
nr. 305
Prishtinë - Kosovë



Akademia e Shkencave e
Shqipërisë
Sheshi "Fan Noli" nr. 7
Tiranë - Shqipëri



PROTOKOLL

PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR SHKENCOR DHE ARTISTIK NDËRMJET AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (Për periudhën 2022 - 2023)

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (më tej: ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), me qëllim që të vazhdojnë të zhvillojnë një bashkëpunim të frytshëm kërkimor-shkencor midis tyre, pas bisedimeve dhe shkëmbimit të mendimeve për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndër-institucionale në përfundim të periudhës së protokollit 2020-2022, nënshkruajnë këtë Protokoll bashkëpunimi për periudhën 2022-2023, duke mbajtur parasysh rëndësinë e shkëmbimit të informacionit shkencor, si dhe ndërmarrjen e nismave të përbashkëta shkencore nga të dyja palët, mbështetur në Marrëveshjen-kuadër ndërmjet dy akademive.

Veprimtaritë e përbashkëta të dy institucioneve do të zhvillohen sipas përshkrimit dhe kalendarit të mëposhtëm dhe përfshijnë fushat: Projektet e përbashkëta, konferencat shkencore dhe botime:

Nr.	Emërtimi i veprimtarisë	Vendi	Koha
1.	<i>Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe</i>	Tiranë- Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
2.	<i>Bashkëpunim në kuadër të nismës shkencore për një Enciklopedi Shqiptare</i>	Tiranë- Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
3.	<i>Vlerësimi i gjendjes dhe sfidave të shkencave ekonomike Shqipëri-Kosovë</i>	Tiranë- Prishtinë	2022-2023
4.	<i>Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Shqipëri-Kosovë</i>	Prishtinë- Tiranë	2022-2023

5.	<i>Nxitja e bashkëpunimit për projekte të përbashkëta studimore në: infrastrukturë, pasuri minerare, ekologji, faunë, florë, gjuhë, enciklopedi, arkeologji.</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
6.	<i>Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore: përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera.</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
7.	<i>Bashkëpunim për studimin e shpërndarjes në hapësirë dhe kohë të aerosoleve dhe temperaturave dhe të korelacionit mes tyre, nëpërmjet përpunimit të imazheve satelitore, modelimeve kompjuterike dhe krahasimit me matjet në terren</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
8.	<i>Studimi i burimeve alternative të energjisë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
9.	<i>Konferencë shkencore: Kritika dhe studimet letrare shqipe në shekullin XXI</i>	Prishtinë	2022, maj-qershor
10.	<i>Konferencë jubilarë për 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit (1972-2022).</i>	Tiranë	10 nëntor 2022
	<i>Konferencë shkencore për 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit</i>	Prishtinë	17 ose 21.11.2022
11.	<i>Konferencë shkencore: Studime albanologjike në Britani dhe në vendet e Europës Veriore</i>	Prishtinë	2023
12.	<i>Konferencë shkencore: 110 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë</i>	Tiranë	2022
13.	<i>Konferencë shkencore: 110 vjetori i Konferencës së Ambasadorëve në Londër</i>	Prishtinë	2023
14.	<i>Konferencë shkencore: Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale</i>	Prishtinë	2022

15.	<i>Konferencë shkencore: Filozofia dhe Poezia</i>	Prishtinë	2023
16.	<i>Konferencë shkencore: Harmonizimi i legjislacionit mes Kosovës dhe Shqipërisë në kuadër të integrimeve evropiane</i>	Prishtinë	2023, gjysma e parë e vitit
17.	<i>Konferencë shkencore: Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri, Kosovë dhe rajon</i>	Prishtinë	2023
18.	<i>Viti i akademizmit shqiptar: 50-vjetori i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë</i>	Tiranë	2022
19.	<i>Nderimi i figurave kryesore dhe akademike të palëve: shkencëtarë, shkrimtarë dhe artistë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
20.	<i>Botim fjalorësh terminologjikë dhe frazeologjikë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
21.	<i>Nxitja e bashkëpunimit për ngritjen e qendrave kërkimore në fusha të reja: robotikë, inteligjencë artificiale, bioteknologji, nanoteknologji, energjetikë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
22.	<i>Vazhdimi i punës për një platformë të përbashkët për një qasje të hapur në botimet dhe periodikët shkencorë.</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
23.	<i>Koncerte dhe ekspozita të përbashkëta me vepra të kompozitorëve dhe të artistëve të Shqipërisë dhe të Kosovës (veprimtari e përbashkët)</i>	Prishtinë-Tiranë	2022-2023 dhe në vazhdim
24.	<i>Panairi i botimeve akademike shkencore dhe përrurimi i botimeve (veprimtari e përbashkët)</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
25.	<i>Bashkëpunim profesional ndërmjet bibliotekave: -Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore dhe artistike të palëve; - Botime të ndërsjella dhe promovime të rezultateve kërkimore shkencore dhe artistike;</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim

<ul style="list-style-type: none"> - Katalogimi online i fondeve albanologjike; - Bibliografite online të kërkuesve shkencorë; - Shkëmbim eksperience në katalogim dhe përurime të bibliografive online të kërkuesve shkencorë shqiptarë; - Kualifikim profesional i stafit bibliotekar mbi katalogimin e njësive bibliografike. 		
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy akademive do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Pikat e këtij Protokoll realizohen pavarësisht se a janë të përfshira në programet e punës të dy akademive.

Dy akademitë bashkëpunojnë për veprimtari të tjera jashtë këtij Protokoll duke u marrë vesh në proces e sipër.

Për takimet dhe vizitat në zbatim të këtij Protokoll shpenzimet e akomodimit i bartë pala ftuese, ose sipas marrëveshjes.

Mënyra e financimit të projekteve të përbashkëta koordinohet me marrëveshje të veçanta për secilën pikë të programit të bashkëpunimit.

Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy akademive, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të mjeteve financiare.

Protokoll është i vlefshëm për një periudhë dy vjeçare.

Nënshkruar në Prishtinë, më 3 mars 2022, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

**PËR AKADEMINË E
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE
TË KOSOVËS**

Akademik Mehmet Kraja, kryetar




**PËR AKADEMINË E
SHKENCAVE
TË SHQIPËRISË**

Akademik Skënder Gjinushi, kryetar






Akademia e
Shkencave e
Shqipërisë
Sheshi "Fan Noli" nr. 7
Tiranë - Shqipëri



PROTOKOLL

PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR SHKENCOR DHE ARTISTIK NDËRMJET AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS (Për periudhën 2022 - 2023)

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (më tej: ASHAK), me qëllim që të vazhdojnë të zhvillojnë një bashkëpunim të frytshëm kërkimor-shkencor midis tyre, pas bisedimeve dhe shkëmbimit të mendimeve për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndër-institucionale në përfundim të periudhës së protokollit 2020-2022, nënshkruajnë këtë Protokoll bashkëpunimi për periudhën 2022-2023, duke mbajtur parasysh rëndësinë e shkëmbimit të informacionit shkencor, si dhe ndërmarrjen e nismave të përbashkëta shkencore nga të dyja palët, mbështetur në Marrëveshjen-kuadër ndërmjet dy akademive.

Veprimtaritë e përbashkëta të dy institucioneve do të zhvillohen sipas përshkrimit dhe kalendarit të mëposhtëm dhe përfshijnë fushat: Projektet e përbashkëta, konferencat shkencore dhe botime:

Nr.	Emërtimi i veprimtarisë	Vendi	Koha
1.	<i>Këshilli Ndërademik për Gjuhën Shqipe</i>	Tiranë- Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
2.	<i>Bashkëpunim në kuadër të nismës shkencore për një Enciklopedi Shqiptare</i>	Tiranë- Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
3.	<i>Vlerësimi i gjendjes dhe sfidave të shkencave ekonomike Shqipëri-Kosovë</i>	Tiranë- Prishtinë	2022-2023
4.	<i>Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Shqipëri-Kosovë</i>	Prishtinë- Tiranë	2022-2023

5.	<i>Nxitja e bashkëpunimit për projekte të përbashkëta studimore në: infrastrukturë, pasuri minerare, ekologji, faunë, florë, gjuhë, enciklopedi, arkeologji.</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
6.	<i>Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore: përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera.</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
7.	<i>Bashkëpunim për studimin e shpërndarjes në hapësirë dhe kohë të aerosoleve dhe temperaturave dhe të korelacionit mes tyre, nëpërmjet përpunimit të imazheve satelitore, modelimeve kompjuterike dhe krahasimit me matjet në terren</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
8.	<i>Studimi i burimeve alternative të energjisë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
9.	<i>Konferencë shkencore: Kritika dhe studimet letrare shqipe në shekullin XXI</i>	Prishtinë	2022, maj-qershor
10.	<i>Konferencë jubilarë për 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit (1972-2022).</i>	Tiranë	10 nëntor 2022
	<i>Konferencë shkencore për 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit</i>	Prishtinë	17 ose 21.11.2022
11.	<i>Konferencë shkencore: Studime albanologjike në Britani dhe në vendet e Europës Veriore</i>	Prishtinë	2023
12.	<i>Konferencë shkencore: 110 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë</i>	Tiranë	2022
13.	<i>Konferencë shkencore: 110 vjetori i Konferencës së Ambasadorëve në Londër</i>	Prishtinë	2023
14.	<i>Konferencë shkencore: Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale</i>	Prishtinë	2022

15.	<i>Konferencë shkencore: Filozofia dhe Poezia</i>	Prishtinë	2023
16.	<i>Konferencë shkencore: Harmonizimi i legjislacionit mes Kosovës dhe Shqipërisë në kuadër të integrimi evropiane</i>	Prishtinë	2023, gjysma e parë e vitit
17.	<i>Konferencë shkencore: Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri, Kosovë dhe rajon</i>	Prishtinë	2023
18.	<i>Viti i akademizmit shqiptar: 50-vjetori i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë</i>	Tiranë	2022
19.	<i>Nderimi i figurave kryesore dhe akademike të palëve: shkencëtarë, shkrimtarë dhe artistë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
20.	<i>Botim fjalorësh terminologjikë dhe frazeologjikë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
21.	<i>Nxitja e bashkëpunimit për ngritjen e qendrave kërkimore në fusha të reja: robotikë, inteligjencë artificiale, bioteknologji, nanoteknologji, energjetikë</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
22.	<i>Vazhdimi i punës për një platformë të përbashkët për një qasje të hapur në botimet dhe periodikët shkencorë.</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
23.	<i>Koncerte dhe ekspozita të përbashkëta me vepra të kompozitorëve dhe të artistëve të Shqipërisë dhe të Kosovës (veprimtari e përbashkët)</i>	Prishtinë-Tiranë	2022-2023 dhe në vazhdim
24.	<i>Panairi i botimeve akademike shkencore dhe përrurimi i botimeve (veprimtari e përbashkët)</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim
25.	<i>Bashkëpunim profesional ndërmjet bibliotekave: -Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore dhe artistike të palëve; - Botime të ndërsjella dhe promovime të rezultateve kërkimore shkencore dhe artistike;</i>	Tiranë-Prishtinë	2022-2023 dhe në vazhdim

<ul style="list-style-type: none"> - Katalogimi online i fondeve albanologjike; - Bibliografite online të kërkuesve shkencorë; - Shkëmbim eksperience në katalogim dhe përrurime të bibliografive online të kërkuesve shkencorë shqiptarë; - Kualifikim profesional i stafit bibliotekar mbi katalogimin e njësive bibliografike. 		
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy akademive do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Pikat e këtij Protokoll realizohen pavarësisht se a janë të përfshira në programet e punës të dy akademive.

Dy akademitë bashkëpunojnë për veprimtari të tjera jashtë këtij Protokoll duke u marrë vesh në proces e sipër.

Për takimet dhe vizitat në zbatim të këtij Protokoll shpenzimet e akomodimit i bartë pala ftuese, ose sipas marrëveshjes.

Mënyra e financimit të projekteve të përbashkëta koordinohet me marrëveshje të veçanta për secilën pikë të programit të bashkëpunimit.

Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy akademive, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të mjeteve financiare.

Protokoll është i vlefshëm për një periudhë dy vjeçare.

Nënshkruar në Prishtinë, më 3 mars 2022, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

**PËR AKADEMINË E
SHKENCAVE TË SHQIPËRISË**

Akademik Skënder Gjinushi, kryetar




**PËR AKADEMINË E
SHKENCAVE DHE TË
ARTEVE TË KOSOVËS**

Akademik Mehmet Kraja, kryetar